VENDIM
Nr.352, datë 12.5.2010

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË, NË "BIOLOGJI-KIMI", "HISTORI-GJEOGRAFI" DHE "CIKËL I ULËT DHE ANGLISHT NË CIKLIN FILLOR" NË UNIVERSITETIN "FAN S.NOLI" KORÇË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Hapjen, në universitetin "Fan S.Noli", Korçë, të programeve të studimit të ciklit të parë "Biologji-kimi" dhe "Histori-gjeografi".

2.Hapjen, në filialin e qytetit të Pogradecit, të universitetit "Fan S.Noli", Korçë, të programit të studimit të ciklit të parë "Cikël i ulët dhe anglisht në ciklin fillor".

3.Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet, përkatësisht, "Diplomë e Nivelit të Parë, DNP, në biologji-kimi", "Diplomë e Nivelit të Parë, DNP, në histori-gjeografi" dhe "Diplomë e Nivelit të Parë, DNP, në cikël të ulët dhe anglisht në ciklin fillor".

4.Programet e studimit të ciklit të parë realizohen me 180 kredite, ECTS, dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 (tri) vite akademike.

5.Programet e studimit "Biologji-kimi", "Histori-gjeografi" dhe "Cikël i ulët dhe anglisht në ciklin fillor" të fillojnë veprimtarinë në vitin akademik 2010-2011.

6.Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i universitetit "Fan S.Noli", Korçë, pa efekte buxhetore shtesë.

7.Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe universiteti "Fan S.Noli", Korçë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha